

SETI I KABLLOVE/KABLLO KARIKIMI MODE3 2.0

Spina Typ 2 me Typ 2 dhe të tjera, sipas IEC 62196

Lapp Mobility GmbH, Stuttgart-Deutschland

Për modelet në vijim:

„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-32A3P-xxxx“


„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-20A3P-xxxx“

„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-32A1P-xxxx“

„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-20A1P-xxxx“


Shpjegim:

M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-20A1P-xxxx



Mode 3 2.0

PËRDORIMI I DUHUR

Kabloja e karikimit Mode3 (Typ 2 me Typ 2, IEC) dhe të tjera sipas IEC 62196, është menduar për karikimin e automjeteve elektrike dhe hibride në një infrastrukturë të përshtatshme karikimi me pikat e karikimit të etiketuara sipas EN 17186, p.sh. "C".  përshtatet për spinën Typ 2 për një tension ≤ 480 VAC.

Çdo përdorim tjetër, përveç atij të miratuar nga Lapp Mobility GmbH nuk është i lejuar. Kjo kablo karikimi është e sigurt vetëm nëse ndiqen udhëzimet e përdorimit.

Përpara përdorimit të kablos së karikimit, lexoni këtë manual përdorimi dhe ndiqni udhëzimet e tij. Ju lutemi ta ruani manualin e përdorimit. Krahas këtij manuali, ndiqni edhe udhëzimet e dokumentacionit të automjetit tuaj elektrik apo hibrid si edhe udhëzimet për stacionin tuaj të karikimit.

Mosrespektimi i këtij udhëzimi mund të shkaktojë dëmtim të kablos së karikimit Mode3. Përveç kësaj, kjo shoqërohet me rreziqe të tejsira si p. sh. goditje elektrike, qark i shkurtër ose zjarr.

PËRDORIMI I PAPËRSHTATSHËM

Përdorimi i papërshtatshëm rrit rrezikun e dëmtimit material dhe dëmtimit të shëndetit. Shmangni medoemos veprimet e mëposhtme:

- Ndryshimin/manipulimin e setit të kablllove/të kablos së karikimit,
- Mos e lidhni kabllon e karikimit me sisteme të papërshtatshme prizash,

- Mos shkëlqeni mbi setin e kablllove/kabllon e karikimit,
- Përdorimi i kablllove të karikimit me defekt.

Për çdo dëmtim material apo personal, të cilat rezultojnë nga përdorimi i papërshtatshëm, është përgjegjës përdoruesi dhe jo prodhuesi. Lapp Mobility GmbH nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për dëmet që vijnë nga përdorimi jo i duhur.

UDHËZIMET E SIGURISË

- Fëmijët nuk lejohen të përdorin setin e kabllave/kabllos së karikimit!
- Kafshët duhen mbajtur larg setit të kabllave/kabllos së karikimit!
- Lidhni setin e kabllave/kabllos së karikimit me pajisjet prizë të ofruara dhe të shënuara për këtë qëllim
- Mos përdorni asnjë adaptor, adaptor të ndërmejtëm apo kablo zgjatuese.
- Përdorimi i setit të kabllave/kabllos së karikimit nuk lejohet në ambiente ku ka rrezik shpërthimi si edhe në ambientet ku ka lëngje, gazra ose pluhur të ndezshëm - Rrezik shpërthimi dhe zjarri!
- Përdorni setin e kabllave/kabllos së karikimit vetëm në ambientet e përcaktuara për përdorimin apo për ruajtjen e tyre.

TË DHËNAT TEKNIKE

Seti i kabllave/kablo karikimi Mode3
(Typ 2 me Typ 2, IEC)

Norm IEC 61851-1
Norm IEC 62196

Tensioni nominal (Typ 2 me Typ 2, IEC)

250 V AC 1ph
440 V AC 3ph

Frekuenca nominale

50 Hz/60 Hz

Fuqia nominale Typ 2, IEC

20A / 32A

Kapaciteti i karikimit Typ 2, IEC (20A) 1-phase
„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-20A1P-xxxx“

4,6 kW

Kapaciteti i karikimit Typ 2, IEC (20A) 3-phase
„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-20A3P-xxxx“

13,8 kW

Kapaciteti i karikimit Typ 2, IEC (32A) 1-phase
„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-32A1P-xxxx“

7,2 kW

Kapaciteti i karikimit Typ 2, IEC (32A) 3-phase
„M32-T2Pm-T2Cm-sws-S-32A3P-xxxx“

22 kW

IP mbrojtja nga depërtimi Typ 2, IEC

IP55 (në prizë)

Temperatura e mejdisit

-35°C ... +50°C

Temperatura e magazinimit

-5°C ... +50°C

Lagështia e ajrit

5 – 95% (pa kondensim)

PËRDORIMI

KUJDES

Kur seti i kablllove/kabloja e karikimit janë të dëmtuara – Rrezik për jetën nga goditja elektrike

Vënia në përdorim e një seti kabllosh/kabllos së karikimit mund të çojë në vdekje ose lëndime të rënda.

- Kontrolloni kabllon e karikimit për dëmtime përpara çdo përdorimi. Zëvendësoni setin e kablllove/kabllon e karikimit të dëmtuar kundrejt një të riu.
- Mos përdorni asnjë adaptor apo zgjatues të lidhur me setin e kablllove/kabllon e karikimit.

PASTRIMI

KUJDES

Pastroni kabllon e karikimit vetëm kur tli jetë e shkëputur nga priza

KUJDES

Prekja e komponentëve që përçojnë rrymë - Rrezik për jetën nga goditja elektrike!

Prekja e komponentëve që përçojnë rrymë elektrike mund të çojë në vdekje apo në lëndime të rënda.

- Pastroni setin e kablllove/kabllon e karikimit vetëm kur të jetë e shkëputur nga priza.
- Sigurohuni që të mos hyjë ujë në pjesët e kontaktit.

ASGJËSIMI

Seti e kablllove/kabloja e karikimit nuk lejohet të hidhet në mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Shfrytëzoni për këtë një pikë grumbullimi për riciklimin e pajisjeve

Nisja e karikimit

Kur seti i kablllove/kabloja e karikimit është e lidhur me stacionin e karikimit dhe automjetin elektrik, mund të fillojë procesi karikimit.

Për këtë, ju lutemi të mbani gjithashtu parasysht manualin e përdorimit të automjetit tuaj elektrik dhe hibrid si dhe të stacionit tuaj të karikimit.

Përfundimi i karikimit

Pas përdorimit të setit të kablllove/kabllos së karikimit vendosni kapakun mbrojtës të ofruar nga prodhuesi. Mbështilleni setin e kablllove/kabllon e karikimit pa përthyerje dhe vendoseni atë në vendin e parashikuar për këtë në automjet. Ruajta e përkohshme e kabllos së karikimit Mode3 2.0 në bagazhin e makinës, është e padëmshme deri në temperaturën 65 °C.

VINI RE!

Dëmtime materiale për shkak të pastrimit të gabuar

Pastrimi gabuar mund të çojë në dëmtim material të setit të kablllove/kabllos së karikimit.

- Sigurohuni që të mos hyjë ujë në pjesët e kontaktit.
- Mos përdorni ajër të kompresuar ose pastrues me presion të lartë.
- Fshijeni setin e kablllove/kabllon e karikimit vetëm me një leckë të thatë pa shtuar solucione pastrimi.

Pastrim i thatë

Përdorni vetëm një leckë të thatë për pastrimin dhe fshijeni setin e kablllove/kabllon e karikimit vetëm me të.

vjetra elektrike dhe elektronike. Për këtë, kontaktoni me shitësin tuaj ose drejtpërdrejt me kompaninë tuaj përgjegjëse të asgjësimit.

MAGAZINIMI

- Gjatë përdorimit normal, ruajeni setin e kabllave/kabllon e karikimit në vendin e caktuar për këtë në automjetet.
- Pas përdorimit vendosni kapakun mbrojtës të ofruar nga prodhuesi.
- Mbështillenit setin e kabllave/kabllon e karikimit pa përthyerje dhe vendoseni atë në vendin e parashikuar për këtë në automjetet.
- Nëse seti i kabllave/kabllaja e karikimit nuk nevojitet për një periudhë të gjatë kohore ose duhet të magazinohet, ai duhet patjetër të pastrohet para magazinimit, nëse është i ndotur. Në këtë rast, paketoni setin e kabllave/kabllon e karikimit në paketimin original dhe ruajeni në një vend të pastër dhe të thatë.
- Vini re specifikimet/informacionet tek "Të dhënat teknike".

Vini re gjithashtu edhe shënimet në vet produktin

LAPP MOBILITY - CHARGING CABLE

1.

2. **3.** +50 °C -30 °C **4.**

5. **6.**

7. **8a.** **8b.** **8c.**

Lapp Mobility GmbH
Oskar-Lapp-Str. 2 · D-70565 Stuttgart
Tel.: +49 711 7838 - 7070
www.lappmobility.com
info.lmd@lappmobility.com



Lapp Mobility GmbH
Oskar-Lapp-Str. 2
70565 Stuttgart
Gjermani
www.lappmobility.com